

Departamenti për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete

Sektori për Monitorimin e Sistemit Ligjor

Raport mujor – qershor 2009

Numër i pamjaftueshëm i gjykatësve në Kosovë

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) është e shqetësuar me caktimin e pamjaftueshëm të gjykatësve në gjykatat e Kosovës. Dështimi i vazhdueshëm i autoriteteve për ta trajtuar këtë problem në tërësi mund të përbëjë shkelje të obligimeve të tyre të përgjithshme të përcaktuara me të drejtën ndërkombëtare dhe vendore. Po ashtu, kjo ka pasoja negative të drejtpërdrejta në të drejtat themelore të njeriut siç është e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, e drejta për mjet efikas juridik, e drejta për gjykim para një tribunali të përcaktuar me ligj dhe e drejta në aktvendim të arsyetuar.

OSBE-ja më herët ka raportuar mbi problemet e ndryshme që kanë të bëjnë me mungesën e personelit në gjykatat e Kosovës.¹ Në veçanti, OSBE-ja ka shfaqur shqetësimin e saj mbi ngarkesën e jashtëzakonshme të lëndëve në disa institucione gjyqësore, ka theksuar mospërputhjet e konsiderueshme në ngarkesat e lëndëve të disa gjykatësve në gjykata të shkallës së njëjtë, si dhe ka rekomanduar që emërimi i gjykatësve të rishikohet në pajtim me ngarkesën mesatare të lëndëve, duke marrë parasysh ngarkesën ekzistuese në gjykata.

E drejta ndërkombëtare e cila është e zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë vendos një obligim pozitiv mbi autoritetet për të emëruar një numër të mjaftueshëm të gjykatësve në mënyrë që drejtësia të mund të ndahet “pa vonesa të cilat do të mund ta rrezikonin efikasitetin dhe besueshmërinë e saj”.² Këshilli i Ministrave i Këshillit të Evropës ka nënvizuar rëndësinë e rekrutimit të një numri të mjaftueshëm të gjykatësve në mënyrë që të sigurohet një sistem gjyqësor efikas dhe i drejtë³ dhe ka theksuar se “vonesat e tepërta në ndarjen e drejtësisë [...] përbëjnë një rrezik të rëndësishëm, veçanërisht për sa i përket sundimit të ligjit”.⁴ E drejta lëndore e përcaktuar shumë kohë më parë e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) kërkon nga autoritetet që t’i organizojnë sistemet e tyre ligjore ashtu që gjykatat ta kenë të mundur të jenë në pajtueshmëri me kërkesat e standardeve për të drejtat të njeriut.⁵

¹ Shih Raportin e OSBE-së *Rishikimi i shtatë i Sistemit të drejtësisë penale (1999-2005). Reformat dhe shqetësimet e mbetura (mars 2006)*, faqe 19; shih edhe Raportin e OSBE-së *Kosova – Rishikimi i Sistemit të drejtësisë penale. Administrimi i drejtësisë në gjykatat komunale (mars 2004)*, faqe 10, 16.

² Shih *Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë*, Aktgjykim i GJEDNJ datë 27 tetor 1994, paragrafi 61, i ripohuar në rastin *Ferrari, A. P., Di Mauro dhe Bottazi kundër Italisë*, Aktgjykimi i GJEDNJ datë 28 korrik 1999, paragrafi 21. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe e drejta lëndore korresponduese e GJEDNJ janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme në Kosovë, shih Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24 mbi Ligjin në fuqi në Kosovë, neni 1.3.(b); shih Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, neni 3.2.(b); shih edhe nenet 22(2) dhe 53 të Kushtetutës së Kosovës.

³ Rekomandimi i Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës nr. R (94) 12, parimi III.1(a), 13 tetor 1994, *Mbi pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjykatësve*.

⁴ Rezoluta e Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës DH (97) 336, 11 korrik 1997, *Kohëzgjatja e procedurës civile në Itali: masat plotësuese me karakter të përgjithshëm*.

⁵ Shih *Zimmermann dhe Steiner kundër Zvicrës*, Aktgjykimi i GJEDNJ datë 13 korrik 1983, paragrafi 29.

Ligjet në Kosovë përcaktojnë se Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), si organi përgjegjës për organizimin dhe funksionimin e mirëfilltë të gjyqësorit, përcakton numrin e gjykatësve në çdo juridiksion dhe rekomandon themelimin e gjykatave të reja.⁶

Aktualisht numri i përgjithshëm i gjykatësve në Kosovë është 291. Gjykatat e qarkut mesatarisht kanë tetë deri nëntë gjykatës, ku përjashtim bën Gjykata e qarkut në Prishtinë me 18 gjykatës. Gjykata e qarkut në Prishtinë ka juridiksion shumë më të madh territorial duke mbuluar përafërsisht një milion njerëz. Gjykatat komunale zakonisht kanë ndërmjet 4 dhe 13 gjykatës (ku përsëri, Gjykata komunale në Prishtinës bën përjashtim, me 26 gjykatës). Gjykatat për kundërvajtje kanë ndërmjet dy dhe dhjetë gjykatës.⁷

Përkundër kërkesës së qartë të së drejtës lëndore të GJEDNJ për emërimin e numrit të mjaftueshëm të gjykatësve, shumë gjykata në Kosovë edhe më tej përballesh me një numër të pamjaftueshëm të gjykatësve. Për më tepër, ka mospërputhje të konsiderueshme në ngarkesë të lëndëve me të cilën përballesh gjykatës të ndryshëm në gjykata të shkallës së njëjtë. Mungesa e personelit në disa gjykata dhe mbingarkesa e lëndëve te disa gjykatës ngrehin shqetësime të konsiderueshme mbi pajtueshmërinë e autoriteteve me obligimet e tyre të përgjithshëm të cekura më lart. Një gjë e tillë po ashtu ka ndikim negativ në gëzimin e një numri të drejtave themelore të njeriut nga banorët e Kosovës.

Shkeljet e të drejtave të njeriut si rrjedhojë e numrit të pamjaftueshëm të gjykatësve

Numri i pamjaftueshëm i gjykatësve mund të çojë në një varg shkeljesh të të drejtave të njeriut. Të drejtat të cilat mund të shkelen përfshijnë të drejtën për proces të rregullt, të drejtën për mjet efikas juridik, të drejtën që çështja e tij/saj të dëgjohet drejtësisht nga një gjykatë e përcaktuar me ligj (d.m.th. në pajtim me ligjin), si dhe të drejtën për aktvendime të arsyetuara.

A. E drejta në gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe në mjet efikas juridik

Shumë nga gjykatësit e intervistuar nga OSBE-ja janë ankuar se mungesa e numrit të mjaftueshëm të gjykatësve shkakton vonesa të konsiderueshme në trajtimin e lëndëve penale dhe civile.

Deri në një masë të caktuar, vonesat në trajtimin e lëndëve janë të pashmangshme në gjykatat të cilat kanë mungesë të konsiderueshme të personelit dhe si rrjedhojë nuk mund të fajësohen gjykatësit individualë. Procedurat gjyqësore nuk mund të përshpejtohen në dëm të standardeve tjera të gjykimit të drejtë.

⁶ Ligji Nr. 03/L-123 mbi përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i publikuar më 16 dhjetor 2008 në fuqi prej 1 janarit 2009. Neni 1.7, i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/52 mbi Themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, datë 20 dhjetor 2005.

⁷ Për numrin e saktë të gjykatësve ekzistues/të paraparë në të gjitha gjykatat e Kosovës, shikoni Shtojcën 1 në faqen 8.

OSBE-ja më herët ka raportuar për shkeljet e së drejtës vendore dhe ndërkombëtare që ndodhin kur procedurat penale dhe gjykimet zgjasin në masë të paarsyeshme, siç ndodh me paraburgimet e zvarritura në pritje të gjykimit, si dhe zvarritjet në konfirmimin e padive, caktimin e seancave dëgjimore dhe lëshimin e vendimeve, aktvendimeve dhe aktgjyqimeve.⁸ Në këtë kuptim, situata është posaçërisht shqetësuese në rajonin e Mitrovicës, kur problemi rëndohet edhe më shumë nga mosfunksionimi i gjyqësorit dhe shërbimit të prokurorisë në komunat veriore të këtij rajoni.⁹

OSBE-ja, po ashtu, ka vërejtur me shqetësim se disa herë në lëndë civile gjykatat nuk arrijnë të procedojnë me propozim të kreditorit në kohë të duhur.¹⁰ Zbatimi efektiv i vendimeve gjyqësore është i nënkuptuar në garancinë e të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor. Numri i pamjaftueshëm i gjykatësve e vështirëson këtë zbatim.

Po ashtu, e drejta për një proces të rregullt gjyqësor është e lidhur me garancinë e të drejtës për një mjet efikas juridik para një autoriteti kombëtar për shkeljet e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore KEDNJ.¹¹ GJEDNJ ka përcaktuar se shkelja e së drejtës për një mjet efikas juridik mund të ekzistojë nëse sistemi vendor nuk parashihet gjykim të një shkeljeje të pohuar të njëres të drejtë të konventës para autoritetit vendor brenda një afati të arsyeshëm.¹²

Vonesat e zgjatura në trajtimin e lëndëve, përveç që janë problem në vete, edhe mund të pengojnë aftësinë e përgjithshme të gjykatave në përcaktimin e duhur të së vërtetës, meqë vonesat mund të kenë ndikimin edhe në disponueshmërinë dhe besueshmërinë e provave. *In extremis*, një gjë e tillë madje mund të çojë në parashkrim të lëndëve, posaçërisht në lëndët që përfshijnë kundërvajtje, ku afati i parashkrimit është relativisht i shkurtër.¹³

B. E drejta që çështja të dëgjohet në gjykatë të përcaktuar me ligj

Numri i pamjaftueshëm i gjykatësve mund të çojë edhe në situata ku gjykatat nuk janë në gjendje të përcaktojnë kolegje ashtu si parashihet me ligj, duke shkelur në këtë mënyrë

⁸ Shih, për shembull, Raportin e OSBE-së mbi *Rishikimin e Sistemit të Drejtësisë Penale (1999-2005). Reformat dhe shqetësimet e mbetura (mars 2006)*, faqet 45-47.

⁹ Për më shumë detaje mbi shqetësimet e të drejtave të ndryshme të njeriut që rrjedhin nga mosfunksionimi i plotë i gjyqësorit dhe shërbimit të prokurorisë në rajonin e Mitrovicës, shih Raportin e OSBE-së mbi *Sistemin e drejtësisë në Mitrovicë: Shqetësimet e vazhdueshme të të drejtave të njeriut dhe zhvillimet e fundit (Raporti mujor i SMSL-së për dhjetor 2008)*.

¹⁰ Shih Raportin e OSBE-së – *Raport mujor i Sektorit për monitorimin e sistemit ligjor – shtator 2007*, faqe 3-4. Shih nenin 5.1 të Ligjit nr. 03/L-008 mbi Procedurën ekzekutive i aprovuar me 2 qershor 2008, që thekson se në të gjitha procedurat ekzekutive, “gjykatat kanë detyrë që të veprojnë me urgjencë”. Shih edhe gjuhën e ngjashme të ligjit të mëparshëm mbi procedurën ekzekutive, neni 2(1) dhe 10(1), Ligji mbi procedurën ekzekutive, Gazeta Zyrtare e Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë, 21 prill 1978, nr. 20/78, që kërkon nga gjykatat që të veprojnë menjëherë pas propozimit të kreditorit.

¹¹ Neni 13.

¹² Shih *Ekonomi kundër Greqisë*, Aktgjykimi i GJEDNJ datë 2 korrik 2009, paragrafi 23.

¹³ Neni 27 i Ligjit për Kundërvajtje, Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome (KSA) të Kosovës”, nr. 23/79, përcakton parashkrimin përkatës njëvjeçar dhe parashkrimin absolut dyvjeçar për ndjekjen gjyqësore të lëndëve kundërvajtëse.

garancinë e “gjykatës së përcaktuar me ligj” siç përcaktohet në nenin 6(1) të KEDNJ. Në disa gjykata të cilat kanë mungesa të konsiderueshme të personelit, mund të jetë e pamundur që në praktikë të ndiqen rregullat procedurale mbi përbërjen e kolegjeve gjyqësore apo rregullave mbi diskualifikimin e gjykatësve.

Kjo çështje prek gjykatat e Kosovës në të gjitha nivelet, nga më të lartat në ato më të ulëtat. Gjykata Supreme e Kosovës, për shembull, në kohën kur është shkruar ky raport kishte 14 gjykatës; që do të thotë se gjykata aktualisht nuk mund t’i themelojë tri kolegje prej pesë gjykatësve në të njëjtën kohë¹⁴ dhe disa gjykatës duhet të ulen deri në gjashtë kolegje të ndryshme gjatë një dite.

Gjykatat të cilat kanë vetëm një apo dy gjykatës¹⁵ janë në pozita edhe më të vështira. Është e natyrshme që në gjykata të tilla thjeshtë të jetë e pamundur formimi i kolegjeve prej tre gjykatësve – përkundër faktit që ligji në mënyrë të qartë kërkon formimin e kolegjeve të tilla për çështje specifike.¹⁶ Lëndët që kërkojnë kolegje prej tre gjykatësve të cilat dalin para këtyre gjykatave duhet të transferohen në gjykata tjera, të cilat i kanë të paktën tre gjykatës. Në gjykatat që kanë vetëm një gjykatës, ai gjykatës duhet të transferojë lëndën të një gjykatë tjetër nëse ligji kërkon nga ai që të diskualifikojë veten për çfarëdo arsye. Ndonëse ligji përcakton rregulla obligative për diskualifikimin e gjykatësve në disa raste, në gjykatat që kanë vetëm një gjykatës, lënda duhet të transferohet.¹⁷

C. E drejta për aktvendime të arsyetuara

Është parim themelor i së drejtës, që pasqyrohet si në të drejtën ndërkombëtare ashtu dhe në atë vendore, që aktvendimet e gjykatës të hartohen në mënyrë të qartë dhe të mbështeten me arsye relevante dhe të mjaftueshme.¹⁸ Kjo kërkesë është posaçërisht e rëndësishme për sa i përket vendimeve mbi paraburgim, por ajo duhet të ndiqet edhe në të

¹⁴ Shih nenin 26 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/26, 6 korrik 2003, me ndryshimet pasuese (tani e tutje, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës KPPK).

¹⁵ Për shembull, Gjykata komunale në Kamenicë ka vetëm dy gjykatës, njëri nga të cilët është Kryetar gjykate. Edhe Gjykata komunale e Podujevës i ka vetëm dy gjykatës. Kryetari i Gjykatës komunale të Dragashit ka theksuar se ka punuar i vetëm prej 2007.

Gjykata për kundërvajtje në Kamenicë, si dhe gjykata për kundërvajtje në Malishevë, kanë vetëm nga një gjykatës, i cili është edhe kryetar gjykate. Në një intervistë në korrik të vitit 2009 me OSBE/SMSL, kryetari i gjykatës së lartë për kundërvajtje informoi SMSL-në se aktualisht janë shtatë gjykata për kundërvajtje në Kosovë të cilat kanë vetëm nga një gjykatës, i cili po ashtu kryen edhe funksionin e kryetarit të gjykatës. Kryetari po ashtu theksoi se gjykata e lartë për kundërvajtje ka vetëm pesë gjykatës, që do të thotë se ajo nuk mund të formojë më shumë se një kolegje prej tre gjykatësve në të njëjtën kohë. Një gjë e tillë është problematike duke marrë parasysh faktin se kjo gjykatë funksionon si gjykatë e shkallës së dytë për të 26 Gjykatat për kundërvajtje në Kosovë.

¹⁶ Për shembull, KPPK përcakton se për kërkesat për paraburgim në pritje të gjykimit, të parashtuara si pjesë e padisë, vendimi duhet të merret nga një kolegje prej tre gjykatësve (neni 306(4) KPPK). Po ashtu, paraburgimi fillestar mund të zgjatet vetëm përmes një vendimi prej një kolegji të përbërë nga tre gjykatës (neni 285(3) KPPK).

¹⁷ Shih nenin 40 KPPK dhe neni 67 të Ligjit të Kuvendit të Kosovës nr. 03/L-006 mbi Procedurën kontestimore, 30 qershor 2008.

¹⁸ Neni 5(3) dhe 6(1) KEDNJ. Neni 283(1) dhe 396 KPPK.

gjitha vendimet tjera të gjykatës, posaçërisht në aktgjykime. Arsyetimi adekuat i një vendimi është i domosdoshëm në mënyrë që të pandehurit të mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për të sfiduar ligjshmërinë e një vendimi me të cilin ata nuk pajtohen, si dhe është i dobishëm për të siguruar shqyrtim publik të akteve gjyqësore.

Është e kuptueshme që gjykatësit që punojnë në gjykata me mungesë të personelit, e që përballen me ngarkesa të jashtëzakonshme të lëndëve, kanë vështirësi që të veprojnë në përputhje me këtë kërkesë. Shpeshherë, për t'iu përmbajtur afateve kohore ligjore të përshkuara për procedura të ndryshme, këta gjykatës nuk kanë opsion tjetër veçse të nxjerrin aktvendime, vendime e madje edhe aktgjykime që përmbajnë arsytetime të pamjaftueshme. Kështu, nevoja për një arsyetim adekuat dhe të bazuar në një analizë të thukët të lëndës bjen viktimit për hir të sigurimit të pajtueshmërisë me afatet kohore të përcaktuara me të drejtën procedurale.

Rregullimet e improvizuara nëpër gjykata si rezultat i mungesës së personelit

Në mënyrë që t'i përmbushin si duhet detyrat e tyre sipas ligjit, si dhe t'u shmangen shkeljeve të të drejtave të njeriut të përshkruara më lart, gjykatësit e Kosovës duhet të bëjnë rregullime *ad hoc* për t'i proceduar lëndët penale dhe civile.

Për shembull, Gjykata për kundërvajtje në Gjilan, duke pasur pesë gjykatës, shumë shpesh ia "huazon" njërin nga gjykatësit e saj Gjykatës për kundërvajtje në Kamenicë, që ka vetëm një gjykatës që njëkohësisht vepron edhe si kryetar i gjykatës. Në mënyrë të ngjashme, një gjykatës i Gjykatës për kundërvajtje në Vushtrri është caktuar dhe ende punon në një lëndë penale që i takon juridiksionit të Gjykatës komunale në Skenderaj, për shkak se kjo e fundit ka vetëm dy gjykatës.

Për më tepër, kur gjykatat nuk mund ta formojnë kolegjin e gjykatësve për shkak se kanë më pak se tre gjykatës të punësuar, lëndët i përcillen gjykatave në afërsi që kanë numër të mjaftueshëm të gjykatësve. Kështu, Gjykata komunale në Kaçanik dhe Gjykata komunale në Glllogovc, kur nuk mund ta formojnë kolegjin prej tre gjykatësve, ia dërgojnë lëndët e tyre Gjykatës komunale në Prishtinë. Gjykata komunale në Kamenicë, duke pasur vetëm dy gjykatës, ia përcjell Gjykatës së qarkut në Gjilan të gjitha lëndët ku sipas procedurës kërkohet kolegji prej tre gjykatësve.¹⁹ Masat e tilla, edhe atëherë kur përdoren, duhen të jenë vetëm të përkohshme dhe nuk e zëvendësojnë caktimin e numrit të mjaftueshëm të gjykatësve në secilën gjykatë në Kosovë.

Përfundim dhe rekomandime

Gjykatësit e Kosovës nga gjykatat e të gjitha shkallëve, prej gjykatave për kundërvajtje në komunat më të largëta e deri të Gjykata Supreme e Kosovës në Prishtinë, kanë

¹⁹ Një dërgim i tillë i lëndës lejohet sipas Nenit 28 të Ligjit mbi gjykatat e rregullta, Gazeta zyrtare nr. 21/78 e KSA të Kosovës, që thotë: "Nëse pranë gjykatës komunale për shkak të numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve nuk mund të formohet kolegji [...], punët nga kompetenca e këtij kolegji do t'i kryejë kolegji i gjykatës së qarkut".

shprehur brengat e tyre rreth shkeljeve të të drejtave të njeriut të nënvizuara më lart. Është jashtëzakonisht e vështirë për gjykatësit e stërngarkuar me lëndë që njëkohësisht t'i përmbushin detyrat e tyre gjyqësore, t'i ruajnë standardet më të larta të profesionalizmit dhe ekspertizës ligjore dhe të angazhohen në aftësimin dhe arsimimin adekuat dhe të vazhdueshëm ligjor.²⁰

Mungesa e jashtëzakonshme e personelit mund të ketë edhe pasoja më të gjëra negative. Pamundësia e gjykatësve për t'i gjykuar rastet brenda afatit të parashkrimit ligjor dhe në pajtim të plotë me procedurën e paraparë me ligj mund ta thellojë mosbesimin e publikut ndaj gjykatave, si dhe ta dobësojë besimin e publikut për sundimin e ligjit në përgjithësi.²¹ Mund të ndodhë që individët të mos i sjellin kontestet e tyre në gjykatë nëse besojnë që lëndët e tyre nuk do të procedohen brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Caktimi i gjykatësve në gjykatat e Kosovës duhet të bazohet në një shqyrtim të kujdesshëm të ngarkesës me lëndë të secilës gjykatë, ashtu që të garantohen kushtet e njëjta të punës për të gjithë gjykatësit dhe të parandalohen dallimet e mëdha mes ngarkesave me lëndë të gjykatësve nëpër gjykata të ndryshme.

Shumë nga gjykatësit që i ka intervistuar OSBE-ja kanë thënë që e shohin gjyqësorin si degën më “të lënë anash” nga tri degët e qeverisë. Disa kryetarë të gjykatave theksuan që i janë ankuar vazhdimisht KGJK-së duke kërkuar caktimin e më shumë gjykatësve për gjykatat e tyre, mirëpo pa sukses. Shumë gjykatës kanë shprehur shpresën që me përfundim të “procesit të përshtatshmërisë”²² do të caktohen më shumë gjykatës në gjykatat që ballafaqohen me ngarkesa të mëdha me lëndë dhe kanë mungesë të personelit.

Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) ka bërë përpjekje për ta zgjidhur problemin e mungesës së personelit në gjykata përmes përzgjedhjes dhe aftësimit ekstensiv të kandidatëve për emërimë gjyqësore.²³ Në dhjetor të vitit 2009, në IGJK do të diplomojë klasa e parë e tij prej 30 profesionistëve ligjorë që do të bëhen kandidatë për gjykatës dhe prokurorë. Një klasë tjetër prej 56 individëve do ta fillojë programin 15-muajsh në IGJK në shtator të vitit 2009.

Duke qenë të ballafaquar me ngarkesën me raste gjithnjë në rritje, disa gjykatës nga gjykatat e Kosovës me mungesë të personelit kanë bërë përpjekje që meritojnë lëvdatë për t'i përmbushur kërkesat e ligjit dhe për t'i respektuar të drejtat themelore të njeriut. Megjithatë, përkundër këtyre përpjekjeve, vazhdojnë të bëhen shkelje të të drejtave të njeriut si rezultat i numrit të pamjaftueshëm të gjykatësve. Në mënyrë që të parandalohen

²⁰ Paragrafi 3, Kapitullit III, A, i Kodit të etikës dhe sjelljes profesionale për gjyqtarë.

²¹ Rezultatet e mendimit publik në vazhdim tregojnë se gjykatat janë më së paku të besueshme nga institucionet Kosovare. Shih, UNDP raportin për paralizim të hershëm- fakte të shpejta 24 prill 2009 faqe 2 dhe 5.

²² “Procesi i emërimit”, që filloi më 13 shkurt 2009, është një shqyrtim gjithëpërfshirës dhe mbarëkosovar për përshtatshmërinë e të gjithë kandidatëve për emërimë të përhershme për gjyqtarë dhe prokurorë në Kosovë.

²³ IGJK është qendra kryesore për aftësimin gjyqësor në Kosovë dhe ka përgjegjësi sipas ligjit për të ofruar aftësim profesional për të gjithë gjykatësit dhe prokurorët në sistemin e drejtësisë në Kosovë. Shih Ligjin nr. 02/L-25 mbi themelimin e Këshillit Gjyqësorë të Kosovës, shpallur me 23 shkurt 2006..

shkeljet e mëtejshme, autoritetet duhet ta përmbushin në tërësi obligimin e tyre për të caktuar numër të mjaftueshëm të gjykatësve në të gjitha gjykatat në Kosovë. Për ta forcuar gjyqësorin, do të duhej të emërohen gjykatës të ri në vendet e lira të punës, të caktohen gjykatës shtesë në gjykatat e mbingarkuara me lëndë, dhe të rindahen resurset mes gjykatave në pajtim me ngarkesën e tyre me lëndë.

Gjykatat duhet të kenë numër të mjaftueshëm të gjykatësve për të garantuar që ato të jenë në gjendje ta përmbushin detyrën e tyre për të ofruar dhe siguruar drejtësi në mënyrë të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm kohor. Duke e pasur parasysh këtë, OSBE-ja rekomandon si në vijim:

- KGjK-ja do të duhej të sigurojë emërimin e numrit të mjaftueshëm të gjykatësve në të gjitha gjykatat e Kosovës ashtu që të gjithë banorëve të Kosovës t'u garantohet e drejta efikase për proces të rregullt para një gjykate.
- Nëse është e nevojshme, do të duhej të themelohet një komision, i përbërë nga përfaqësuesit e gjykatësve, prokurorëve dhe personelit përkrahës, për t'i vlerësuar nevojat reale për personel në gjyqësorin e Kosovës dhe për t'i dhënë propozime KGjK-së, Kuvendit të Kosovës, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave lidhur me rritjen e numrit të gjykatësve.
- Gjykatat e Kosovës do të duhej të bashkëpunojnë ngushtë për t'i ndarë me njëra-tjetrën "praktikat më të mira" për ta trajtuar ngarkesën e madhe me lëndë.
- Do të duhej të përmirësohen kushtet e punës së gjykatësve; në veçanti, do të duhej të rriten pagat e tyre dhe të jenë në një vijë me të ardhurat e përfaqësuesve të degës ekzekutive dhe legjislative, ashtu që postet gjyqësore të jenë tërheqëse dhe të vlefshme për t'u ruajtur për juristët me kualifikime të larta.
- KGjK do të duhej që gjithashtu ta ofrojë një ambient për gjykatësit dhe personelin e tyre përkrahës ku do të angazhoheshin për avancim dhe zhvillim profesional përmes aftësimeve profesionale të përgjithshme dhe specifike në IGjK.
- KGjK, Kuvendi i Kosovës, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave do të duhej të vazhdojnë ta përkrahin IGjK-në ashtu që të mund ta rrisë numrin e kandidatëve të ri për gjykatës dhe prokurorë që i aftëson për çdo vit.

Shtojca 1. Numri i gjykatësve në gjykatat e Kosovës

Të dhënat statistikore zyrtare që i ka publikuar Departamenti i Statistikës i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës *Shpërndarja e gjyqtarëve sipas secilit nivel të gjykatave.*

	Komuna	Numri i përgjithshëm i gjykatësve në gjykatë (aktual/i paraparë)
Gjilan	<i>Gjykata e qarkut në Gjilan</i>	6/8
	<i>Gjykata komunale në Gjilan</i>	8/11
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Gjilan</i>	5/6
	<i>Gjykata komunale në Kaçanik</i>	3/3
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Kaçanik</i>	2/2
	<i>Gjykata komunale në Kamenicë</i>	3/3
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Kamenicë</i>	1/2
	<i>Gjykata komunale në Viti</i>	3/4
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Viti</i>	3/3
Mitrovicë	<i>Gjykata e qarkut në Mitrovicë</i>	9/11
	<i>Gjykata komunale në Mitrovicë</i>	8/8
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Mitrovicë</i>	5/6
	<i>Gjykata komunale në Leposaviq</i>	Gjykata nuk vepron
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Leposaviq</i>	Gjykata nuk vepron
	<i>Gjykata komunale në Zubin Potok</i>	Gjykata nuk vepron
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Zubin Potok</i>	Gjykata nuk vepron
	<i>Gjykata komunale në Skenderaj</i>	2/3
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Skenderaj</i>	1/2
	<i>Gjykata komunale në Vushtrri</i>	4/6
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Vushtrri</i>	3/3

<i>Pejë</i>	<i>Gjykata e qarkut në Pejë</i>	8/11
	<i>Gjykata komunale në Pejë</i>	8/11
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Pejë</i>	8/8
	<i>Gjykata komunale në Deçan</i>	4/4
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Deçan</i>	2/2
	<i>Gjykata komunale në Istog</i>	4/4
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Istog</i>	3/1
	<i>Gjykata komunale në Klinë</i>	3/3
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Klinë</i>	3/2
	<i>Gjykata komunale në Gjakovë</i>	6/8
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Gjakovë</i>	4/6
	<i>Prishtinë</i>	<i>Gjykata Supreme e Kosovës</i>
<i>Gjykata e lartë për kundërvajtje</i>		5/5
<i>Gjykata ekonomike</i>		4/4
<i>Gjykata e qarkut në Prishtinë</i>		18/18
<i>Gjykata komunale në Prishtinë</i>		26/28
<i>Gjykata për kundërvajtje në Prishtinë</i>		9/15
<i>Gjykata komunale në Ferizaj</i>		6/10
<i>Gjykata për kundërvajtje në Ferizaj</i>		5/6
<i>Gjykata komunale në Gllogovc</i>		3/3
<i>Gjykata për kundërvajtje në Gllogovc</i>		2/2
<i>Gjykata komunale në Lipjan</i>		4/5
<i>Gjykata për kundërvajtje në Lipjan</i>		3/3
<i>Gjykata komunale në Podujevë</i>		3/5
<i>Gjykata për kundërvajtje në Podujevë</i>		5/4

Prizren	<i>Gjykata e qarkut në Prizren</i>	9/9
	<i>Gjykata komunale në Prizren</i>	13/12
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Prizren</i>	10/11
	<i>Gjykata komunale në Suharekë</i>	5/4
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Suharekë</i>	3/3
	<i>Gjykata komunale në Malishevë</i>	3/3
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Malishevë</i>	1/2
	<i>Gjykata komunale në Dragash</i>	1/3
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Dragash</i>	2/2
	<i>Gjykata komunale në Rahovec</i>	5/4
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Rahovec</i>	3/3
	Gjithsej	

Shtojca 2. Të dhënat statistikore për gjykatat për kundërvajtje të Kosovës

Të dhënat statistikore zyrtare që i ka publikuar Departamenti i Statistikës i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2008 në *Raportin statistikor për punën e gjykatave për kundërvajtje: Raporti vjetor 2008*.

	Gjykata për kundërvajtje	Numri i përgjithshëm i gjykatësve në gjykatë (aktual/i paraparë)	Lëndët e pranuar	Numri mesatar i lëndëve të pranuar për një gjykatës	Lëndët e zgjidhura	Numri mesatar i lëndëve të zgjidhura për një gjykatës
<i>Gjilan</i>	<i>Gjykata për kundërvajtje në Gjilan</i>	5/6	16,721	3,344.2	16,415	3,283.0
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Kamenicë</i>	1/2	3,301	3,301.0	2,557	2,557.0
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Viti/Vitina</i>	3/4	5,725	1,908.3	6,186	2,062.0
<i>Mitrovicë</i>	<i>Gjykata për kundërvajtje në Leposaviq</i>	Gjykata nuk vepron				
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Zubin Potok</i>	1	142	142.0	116	116.0
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Mitrovicë</i>	Gjykata nuk vepron				
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Skenderaj</i>	1/2	3,474	3,474.0	2,043	2,043.0
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Vushtrri</i>	3/3	6,170	2,056.7	5,363	1,787.7

Pejë	<i>Gjykata për kundërvajtje në Deçan</i>	2/2	2,953	1,476.5	2,902	1,451.0
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Istog</i>	3/1	4,004	1,334.7	4,131	1,377.0
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Klinë</i>	3/2	5,552	1,850.7	5,419	1,806.3
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Gjakovë</i>	4/6	8,678	2,169.5	9,058	2,264.5
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Pejë</i>	8/8	12,676	1,584.5	12,639	1,579.9
Prishtinë	<i>Gjykata për kundërvajtje në Shtërpcë</i>	1/1	573	573.0	493	493.0
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Ferizaj</i>	5/6	19,319	3,863.8	19,422	3,884.4
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Gllogovc</i>	2/2	5,948	2,974.0	4,790	2,395.0
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Kaçanik</i>	2/2	3,914	1,957.0	3,699	1,849.5
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Lipjan</i>	3/3	8,549	2,849.7	8,362	2,787.3
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Podujevë</i>	5/4	8,150	1,630.0	8,376	1,675.2
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Prishtinë</i>	9/15	34,253	3,805.9	37,253	4,139.2
Prizren	<i>Gjykata për kundërvajtje në Prizren</i>	10/11	15,301	1,530.1	17,216	1,721.6
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Suharekë</i>	3/3	5,882	1,960.7	5,916	1,972.0
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Malishevë</i>	1/2	4,437	4,437.0	3,879	3,879.0

	<i>Gjykata për kundërvajtje në Dragash</i>	<i>2/2</i>	<i>1,425</i>	<i>712.5</i>	<i>1,460</i>	<i>730.0</i>
	<i>Gjykata për kundërvajtje në Rahovec</i>	<i>3/3</i>	<i>6,714</i>	<i>2,238.0</i>	<i>6,545</i>	<i>2,181.7</i>
<i>Gjithsej</i>		<i>80/91</i>	<i>183,861</i>	<i>2298.26</i>	<i>184,240</i>	<i>2,303.00</i>
<i>Gjykatat e larta për kundërvajtje</i>		<i>5/5</i>	<i>1,876</i>	<i>375.20</i>	<i>1,876</i>	<i>375.20</i>

Shtojca 3. Informata të përgjithshme për gjykatat e rregullta

Të dhënat statistikore zyrtare që i ka publikuar Departamenti i Statistikës i Këshillit Gjyqësor të Kosovë në *Raportin e vitit 2008: Të dhënat statistikore për gjykatat e rregullta*.

Gjendja e lëndëve:

Gjykata	Numri i lëndëve në proces gjatë vitit 2008	Nga numri i përgjithshëm i lëndëve:		Numri i lëndëve që gjykatat i kanë përfunduar gjatë vitit 2008	Numri i lëndëve të papërfunduara në fund të vitit 2008
		Numri i lëndëve të trashëguara të papërfunduara në fund të vitit 2007	Numri i lëndëve të pranuar në proces gjatë vitit 2008		
Gjykata Supreme	6,595	2,889	3,706	4,196	2,399
Gjykatat e qarkut	20,356	8,993	11,363	10,003	10,353
Gjykata Ekonomike	2,072	588	1,484	743	1,329
Gjykatat komunale	460,433	15,0595	309,838	278,546	181,887
Gjithsej	489,456	163,065	326,391	293,488	195,968

Ngarkesa e gjykatësve me lëndë dhe mesatarja e lëndëve të përfunduara për një gjykatës. Numri i lëndëve të papërfunduara në fund të vitit 2008 në krahasim me numrin e lëndëve të papërfunduara në fund të vitit 2007.

Gjykata	Mesatarja e ngarkesës së gjykatës me lëndë të reja për një muaj	Përqindja e efikasitetit të gjykatës (lëndët e përfunduara/ lëndët e reja)	Mesatarja e lëndëve të përfunduara për një gjykatës gjatë një muaji	Lëndët e përfunduara		Rritja apo ulja e përqindjes fundit i vitit 2008/fundi i vitit 2007
				Në fund të tremujorit të dytë 2008	Në fund të tremujorit të tretë 2008	
Gjykata Supreme	22	113%	27	2,889	2,399	-16.96%
Gjykatat e qarkut	23	88%	21	8,993	10,353	15.12%
Gjykata Ekonomike	34	50%	17	588	1,329	126.02%
Gjykatat komunale	231	90%	208	150,595	181,887	20.70%
Gjithsej				163,065	195,968	20.13%